

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.Nr: 08-506/10
 Data/Datum/Date: 08/10/2025
 Shtojca/Dodaci/Annex: -2-
 PRISHTINË (2023)



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada-Government
 Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
 Departamenti për Profesione të Lira-Department of Slobodnih Profesija-
 Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.12/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje Naim Mehulli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Driton Govori, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbardueses Private [redacted] si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted], lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P.nr.164/2017, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Burbuqe Spahija Kërveshi dhe përmbarduesi privat dhe pa prezencën e palës ankuese [redacted] nga [redacted], duke vepruar sipas rekomandimeve të aktgjykimit A.nr.1325/2023 i datës 10.07.2025, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me datën 30.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet poshtë si e pas afatshme, ankesa e palës ankuese [redacted], nga [redacted], e paraqitur më datë 30.03.2023, kundër Përmbarduesit Privat, [redacted], si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted]

A r s y e t i m

Pala ankuese, me datë 30.03.2025, ka parashtruar ankesë të cilën e ka plotësuar me datë 07.04.2023, ndaj Përmbarduesit Privat [redacted], si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted]

Pala ankuese pretendon në ankesë se më veprimin përmbarimor në lenden P.nr.164/2017, përmbaruesi ka bere shkelje duke mos pasur parasysh kërkesat e debitorit për lartësinë e obligimit, kërkesën për ekspertizë financiare dhe vlerës së hipotekës, obligimin e paguar nga debitori ishte i njëanshëm pasi ka mbrojtur vetëm palën kreditore gjatë kryerës se veprimeve përmbarimore dhe pas kësaj pala ankuese ka parashtruar ankesë më datë 30.03.2023, në Ministrinë e Drejtësisë, lidhur më shkelje disiplinore.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë dhe mbetet në tërësi pran raportit të saj të prezantuar në seancën e datës 30.09.2025.

Përmbaruesi Privat, si në deklaratën e dhënë para se çështja të kthehet në rigjykim ashtu edhe në seancën dëgjimore të datës 30.09.2023, përmbaruesi private nuk e ndien veten përgjegjëse për asnjë nga veprimet e ndërmarra përmbarimore në këtë rast.

Komisioni pas vlerësimit të afatshmërisë së ankesës së paraqitur nga pala ankuese gjeti se ankesa është paraqitur pas afati ligjor, siç përcaktohet me nenin 375 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore (LPP), në të cilën përcaktohet se periudha brenda së cilës mund të iniciohet procedura disiplinore nga shkelja e pretenduar është si në vijim: “ *Procedura disiplinore mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vit nga dita e shkeljes*”. Nga kjo rezulton se ankesa e palës ankuese është e paraqitur pas afatit ligjor të lartcekur sepse veprimi i fundit përmbarimor i pretenduar nga pala ankuese si shkelje e veprimeve përmbarimore nga përmbaruesi është i datës 04.03.2019 ku është nxjerr urdhri për dorëzimin e paluajtshmërisë nga përmbaruesi privat i cili këtë urdhër e ka nxjerr pas shitjes me Konkluzion të datës 24.01.2019, ndërsa ankesa nga pala ankuese është paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë me datë 30.03.2023, për këto arsye komisioni nuk u lëshua mëtej në vlerësimin e meritave të kësaj ankese.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr.12/2023 datë 30.09.2025

Kryesues i Komisionit Disiplinor

Naim Mehulli



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij konkluzioni pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.